

Republika e Kosovës QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. Datum Date
5 2	935 30.08.2021
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 31.08.2021
 Nr. 65-935

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037, në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe në bazë të kërkesës për licencim nga BPrAL- kolegji "ESLG" nr. 935 dt. 14.06.2021, nxjerr:

V E N D I M

1. Kolegji "ESLG", licencohet për programin e studimit "Menaxhimi i patundshmërive dhe infrastrukturës" BA, sipas vendimit të AKA-së, nr. 3038/21, datë: 12.08.2021.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe bazuar në kërkesën e kolegjit "ESLG" nr. 935 dt. 14.06.2021, Komisioni i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL, i ka udhëhequr procedurat e nevojshme administrative dhe procedurale me qëllim të vlerësimit të këtij institucioni, prandaj komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Po ashtu, Bartësi Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) – kolegji "ESLG", në Prishtinë, me vendimin e Komisionit për Licencim të Bartësve Privat të Arsimit të Lartë të lëshuar me datë: 30.09.2020, nr. 6 -1770, është licencuar deri me datë: 30.09.2022, sipas vendimit të AKA-s nr. 458/18D, datë: 18.05.2018

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
2. Arkivit të MASHTI;
3. Parashtruesit të kërkesës;
4. DALSHT;
5. DNJBIA;
6. Inspektoratit të Arsimit, MASHTI.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

